



**MBAHEN NDESHJET FINALE NË NIVEL QARKU NË BERAT, ELBASAN, DURRËS, VLORË, LEZHË, GJIROKASTËR DHE KORÇË, PËR DISIPLINËN E VOLEJBOLLIT DHE BASKETBOLLIT**

Programi “Ekipet Sportive në shkolla” është shtrirë në të gjithë Shqipërinë që nga muaji shtator 2022 dhe janë të përfshirë rreth **10,000 fëmijë e të rinj, pjesë e rreth 700 skuadrave**, të cilët janë stërvitur rregullisht 3 herë në javë nga trajnerë profesionistë, dhe janë pajisur me materialet e nevojshme për ecurinë e programit nga qeveria shqiptare. Në kuadër të programit “Ekipet Sportive në Shkolla”, **përgjatë muajit prill kanë vijuar ndeshjet finale në nivel qarku**, për disiplinën e volejbollit dhe basketbollit në qarkun e **Beratit, Durrësit, Vlorës, Lezhës, Gjirokastrës dhe Korçës, duke finalizuar kështu kampionatin në nivel qarku**. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me presidentin e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Z. Fidel Ylli, kanë marrë pjesë në ndeshjet finale, për të ndjekur ecurinë e programit dhe për **dorëzimin e medaljeve dhe kupave për ekipet fituese**. Pas finalizimit të kampionateve në nivel qarku, në muajin maj do të zhvillohen ndeshjet midis qarqeve, e më tej do të zhvillohet edhe kampionati kombëtar për vitin 2022-2023 në të dyja disiplinat, basketboll dhe volejboll, për vajza dhe për djem për të kurorëzuar ekipet fituese në nivel kombëtar.



**MBAHEN TAKIME ME KËSHILLIN VENDOR RINOR ELBASAN DHE SHIJAK**

Në kuadër të **nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimarrëse**, si një nga **prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka zhvilluar një takim me **Këshillin Vendor Rinor Elbasan** si dhe një me Këshillin **Vendor Rinor Shijak** për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit dhe për t'u njohur me sugjerimet që të rinjtë kanë për përmirësimin e tij, në mënyrë që zëri i bashkëmohatarëve të tyre të përcillet denjësisht pranë bashkive përkatëse. Ndër të tjera, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka diskutuar me të rinjtë edhe rreth çështjeve dhe problematikave të ndryshme të secilit qytet dhe planet për zgjidhjen e tyre.



**VIJON BASHKËPUNIMI ME QEVERINË E KOSOVËS PËR TË RINJTË**

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zhvilloi një takim me Zv. Ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, znj. Daulina Osmani, **për të vijuar më tej bashkëpunimin lidhur me aktivitetet sportive me fokus të rinjtë e dy vendeve**. Gjatë takimit u diskutua rreth marrëdhënieve shumë të mira mes dy vendeve dhe thellimin e partneritetit në sport, duke ndarë qëndrime të njëjta **për ndërthurjen dhe fuqizimin e sportit në Shqipëri dhe Kosovë**, për të kaluar nga zhvillimi lokal i sportit në atë rajonal. Biseda u fokusua në shkëmbimin e eksperiencave të mira midis të rinjve dhe shkëmbimin e aktiviteteve sportive në disiplina të ndryshme.



PËR NJË BOTË PLOT SHPRESË



### RISIA E KRIJIMIT DHE PRINTIMIT TË PROTEZAVE ME TEKNOLOGJINË 3D PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI

Tikkun Olam Makers (TOM), mbështetur nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shërbimit dhe Informacionit, sjell **për herë të parë në Shqipëri risinë e krijimit dhe printimit të protezave për individë me aftësi të kufizuara me kosto të ulët, me teknologjinë 3D**. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët fton studentë dhe institucione shtetërore e private për të bashkëpunuar me ide inovative në krijimin dhe realizimin e protezave të përbalueshme nga të gjithë, me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së individëve me aftësi të kufizuara.

Link-u i aplikimit: <https://techspace.al/tom/>

### MBAHEN TAKIME NË KUADËR TË FUQIZIMIT TË SPORTIT PËR TË RINJË NË SHQIPËRI DHE KONFERENCA "ARRITJET DHE SFIDAT E SPORTIT NË SHQIPËRI"

Përgjatë muajit prill, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Presidentin e KOKSH z. Fidel Ylli, ka zhvilluar një sërë takimesh me presidentin e Komitetit Olimpik të Kroacisë (KOK), Presidentin e Lojërave Ndërkombëtare z. Davide Tizziano, Sekretarin e Lojërave Mesdhetare dhe Sekretarin e Federatës Shqiptare të Futbollit z. Iakovos Filippousis, në kuadër të programit **"Ekipet Sportive në shkollë"**. Ecuria, suksesi dhe vizioni i programit në 61 bashkitë e vendit kanë qenë në fokus të këtyre takimeve të njëpasnjëshme. Ndër të tjera në fokus të diskutimit u vendos **risia e përzgjedhjes së lojtarëve më të mirë, si një praktikë dhe mundësi e mirë për evidentimin e talenteve të së ardhmes, si dhe u evidentua ofrimi falas i këtij programi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë** duke u krijuar atyre mundësi të barabarta për të zhvilluar talentet dhe për të siguruar mirëqënien nëpërmjet sportit. Këto diskutime u ndoqën nga Konferenca "Arritjet dhe sfidat e sportit në Shqipëri", ku u diskutua rreth zhvillimeve të sportit, por edhe sfidat dhe angazhimet për të ardhmen.



### ZBATIMI I KURSIT TË PERMAKULTURËS NË SHKOLLËN "KOLI ALLKANJARI", DIVJAKË.

Në kuadër të **programit Jashtë Orarit Mësimor**, i cili nisi **zbatimin në fund të muajit janar 2023 në 200 shkollë të Shqipërisë**, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përgjatë muajit prill zhvilloi një vizitë në shkollën "Koli Allkanjari" të Divjakës, për të parë nga afër zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij kursi. Gjatë vizitës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët pati mundësinë të vështronte nga afër punën e mrekullueshme që nxënësit kanë bërë për mirëmbajtjen e serës dhe kopshtit dhe bisedoi me nxënësit që marrin pjesë në këtë kurs, duke dëgjuar njëkohësisht edhe komentet dhe sugjerimet e tyre për kursin. **Ky kurs, pjesë e programit jashtë orarit mësimor, jo vetëm u mëson nxënëseve kujdesin dhe përkushtimin ndaj produkteve bujqësore, por mbi të gjitha nxit ndjenjën e kujdesit për njëri – tjetrin dhe vetveten.**





## PREZANTIMI I KAPITULLIT 26 "ARSIMI DHE KULTURA" DHE POLITIKAT RINORE NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

Në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi së bashku me delegacionin shqiptar në takimin bilateral të mbajtur më datë 27 prill, për Kapitullin 26 "Arsimi dhe Kultura", prezantoi politikat e marra deri më tani për rininë dhe punën e bërë për zbatimin e tyre. Muzhaqi shfaqti para Komisionit të Evropës **progresin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe prioritetet e saj, Programin e Kodimit, Programin Kombëtar të Praktikave të Punës**. Ndër të tjera, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët **prezantoi programin Jashtë Orarit Mësimor**, që ofron kurse pa pagesë në fushat art, zeje, sport dhe mjedis. Gjithashtu prezantoi programin e "Ekipeve Sportive në shkollë" si një ndër programet më të suksesshme që ndihmon në përmirësimin e mirëqenies të të rinjve dhe përfshirjes aktive të tyre në shoqëri. **Për fuqizimin e të rinjve në vendimmarrje prezantoi Këshillat Vendorë Rinorë**, të cilët janë ngritur në 57 bashki nga 61 bashkitë e vendit, si edhe foli për punën e kryer **së bashku me Agjencinë Kombëtare të Rinisë për riformatimin e thirrjeve për projekt-propozime sipas metodologjisë LOD** (metodologjia për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile).



## ZHVILLOHEN AKTIVITETE NË KUADËR TË THIRRJES II TË PROJEKT-PROPOZIMEVE RINORE

Përgjatë muajit prill, **organizatat fituese të Thirrjes II kanë vijuar me zhvillimin e aktiviteteve për fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve rinore mbi aftësimin digjital, si dhe ndërlidhjen me tregun e punës, gjithëpërfshirjen dhe nxitjen e tyre përmes qasjeve novative.**

Disa nga aktivitetet e zhvilluara janë: "Trajnimi i Punonjësve Rinor" nga Shoqata Amad; **"Qyteti Im Evropian, Edicioni IV"** nga qendra ABC Tirana, ku 40 të rinjve të moshës 15-17 vjeç iu dha mundësia të prezantonin krijimet e tyre si pjesë e një ekspozite; **"Këshillimi në karrierë, aftësitë e buta dhe kanalet e punësimit jo-tradicionale"** organizuar nga Power of Education në kuadër të projektit **"Super Youth"**; sesione trajnimi për të rinjtë e qytetit të Vlorës dhe Fierit, për përgatitjen e një jetëshkrimi, letre motivimi, aplikimi të suksesshëm në punë, për leadershipin dhe aftësimin në sipërmarrje organizuar nga ANEI në kuadër të projektit **"Rinia – Garanci për të Ardhmen Europiane të Vendi"**; leksione dhe trajnime në kuadër të projektit **"Zhvillimi i Kompetencave tek të Rinjtë dhe Sipërmarrësit e Shekullit XXI në Shqipëri"** nga A.S.D.

## ÇELET THIRRJA III PËR PROJEKT-PROPOZIME

Agjencia Kombëtare e Rinisë, mbështetur nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, shpall **Thirrjen publike nr. III për projekt-propozime, drejtuar organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë**. Thirrja III për projekt-propozime synon të adresojë tre prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029:

- Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetja e aktivizimit shoqëror dhe qytetar të tyre.
- Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
- Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

**Thirrja do të qëndrojë e hapur për 30 ditë, duke filluar nga data 27 prill deri më 26 maj 2023.**